



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agjencia Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 01.10.19

Ref.: 1888/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 78-të të mbajtur më 29.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet pjesërisht kërkesa e Kolegjit "Heimerer" Nr. 1491/19H, datë 29.08.2019 për riakreditim të programeve të studimit:
  - Infermieri Intensive, MA Profesional, 120 ECTS
  - Audiologji, MA Profesional, 120 ECTS,
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

I. Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë (kërkesa Nr. 1491/19H, datë 29.08.2019) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit: 1. Infermieri Intensive, MA Profesional, 120 ECTS, 2. Audiologji MA Profesional, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018 (tash e tutje UA për Akreditim), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Heimerer.


Bazuar në pikën 1.2 të Neni 10 të UA për Akreditim, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në

**AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim**

*mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC erdhi në përfundim se programet e sipër përmendura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me aktet ligjore në fuqi.*

Bazuar në Nenin e referuar më lartë, KShC në mbledhjen e mbajtur më 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Kolegj. Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programin me të cilin ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar nga ky institucion për stafin akademik, dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ, neni 27, pika 2.1, rreth kriterëve për programet të cilat shpiejn në marrjen e një diplome profesionale, dhe neni 25, pika 5.3.4, rreth relevances së fushës për secilin staf akademik të propozuar për atë program, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.